



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazno

Nr. -1-78
Br.

Data 19.06.2023
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.25.05.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi, Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun dhe përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.-II-634, të dt.11.05.2023, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Kuvendit Komunal nr.-I-4, të dt.24.12.2021
4. Dhënia në debat publik e Draft Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.-II-634, të dt.11.05.2023, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Kuvendit komunal nr.-I-4, të dt.24.12.2021.

Enver Gashi – Ne jemi për që kjo pikë e rendit të ditës ti delegohet Kuvendit, pastaj në Kuvend do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Në fakt kërkesa nuk ka ndonjë arsyetim edhe pse po dihet arsyeja dhe ne abstenojmë në këtë pikë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën e Ktyetarit të Komunës nr.-II-634, të dt.11.05.2023, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-4, të dt.24.12.2021.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet dhënien në debat publik të Draft Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës ti rekomandohet Kuvendit dhe aty secili do ta japim kontributin.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që Draft Planit i veprimit për cilësi të ajrit ti rekomandohet Kuvendit dhe rrjedhimisht të dalë në debat publik.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal dhënien në debat publik të Draft Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj se z.Fadil Curri më heret ka bërë kërkesë për lirim të sallës së Kuvendit komunal për aktivitetin e tij dhe ne atë kërkesë menjëherë e kemi ceduar në Drejtorinë e administratës së përgjithshme.

E kemi një kërkesë nga Hanefi Raqi, nga Mazgiti i Epërm, i cili ka kërkuar emërtimin e një rruge me emrin “Jakup Raqi”.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht kërkesën në fjalë ia rekomanduan për shqyrtim Komisionit për emërtim të rrugëve, (DPUKP).

Kryesuesja –Po ashtu, e kemi një kërkesë në formë peticioni për hapjen e rrugës për qarkullimin e automjeteve deri në 3.5 tonë dhe në lartësinë maksimale deri në 2.50 metra, që lidhë lagjen “Minjerat” ose siç njihet ndryshe lagja te Kosova B në rr.”Isa Boletini”.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht kërkesën e cekur më lartë ia rekomanduan për shqyrtim Drejtorisë për infrastrukturë lokale.

Kryesuesja – Ju njoftoj se një kërkesë e kemi ceduar në DSHMS dhe për një sqarim detal fjalën ia japë drejtoreshës. Unë iu kam thënë që kërkesat e tilla Zyra pritëse ti rekomandoj aty ku duhet dhe të mos adresohen më në Kuvend.

Blerona Mehmeti Shabanaj – Ne e kemi pranuar kërkesën e znj.Fahrije Ismajli, ku është edhe numri i saj i telefonit dhe ne kemi provuar të kontaktojmë me zonzjën, por numrii saj nuk ekziston. Ne nuk kemi email adresë të zonzjës në fjalë, dokumentacioni është i mangët, vetëm kërkesa dhe letërnjoftimi, kështu që afati është deri me dt.27 për kthim të përgjegjes. Ne po presim edhe nesër, e nëse s’ka asgjë atëherë kërkesa i refuzohet.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Kreshnik Balaj për marrëveshje për kthim prone.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht kërkesën në fjalë ia rekomanduan për shqyrtim DPUKP-së.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Drejtoria e administratës së përgjithshme që Plani i Veprimit për Transparencë të futet në rend dite për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e Kuvendit komunal.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kërkesa e Drejtorisë së administratës ti rekomandohet Kuvendit dhe aty, ne do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Gjithsesi se jemi për dhe në Kuvend do të provojmë me dhënë kontributin tonë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DAP-ja, nr.-III-139, të dt.23.05.2023 lidhur me Draft Planin e Veprimit për Transparencë 2023-2027.

Kryesuesja – Ju njoftoj se MMPH-ja, e ka shqyrtuar vendimin e Planit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Obiliqit dhe kanë kërkuar që ky plan të jetë për periudhën 2023-2027, e jo siq është 2023-2028.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga MMPHI-ja, nr.2477-2/23, e dt.17.05.2023 lidhur me Draft Planin për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Kryesuesja – Ju njoftoj se MPB-ja, na ka dërguar një shkresë lidhur me aprovimin e Kodit Etik për zyrtarë të Komunës së Obiliqit, se është i panevojshëm vazhdimi më tutje për miratimin e Kodit Etik sepse e njehta është në MPB dhe nuk është në harmoni me rregullimin e njëtrajtshëm për të gjithë zyrtarët publik. Me dt.11.05.2023, Drejtoria e administratës, iu ka drejtue me një shkresë MPB-së, duke kërkuar sqarim pse në disa Komuna është aprovuar Kodi Etik, ndërsa në Komunën tonë është anuluar. Po ashtu, Kodi Etik është kërkuar nga auditori i përgjithshëm si dhe në performancë të Komunës. Meqë, kjo çështje është në procedurë e lus drejtoreshën të na njoftoj për çdo gjë në mënyrë që unë pastaj, ti njoftoj anëtarët e Kuvendit Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit Komunal lidhur me kërkesën për konfirmimin e ligjshmërisë nga MPB-ja, për vendimin nr.-I-25, të dt.01.03.2023, për aprovimin e Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Ne kishim pasë dëshirë që në seancën e dt.31 të kemi një shpjegim nga Drejtoria e bujqësisë lidhur me subvencionimin e bujqëve. Në këto 2 vitet e fundit nuk është vërejtë se ka ndonjë subvencionim në ndonjë fushë, ose në ndonjë kategori të bujqësisë, kështu që do të kishim pasë dëshirë që në seancën e ardhshme të marrim një shpjegim këtu, se cilat janë arsyt. Nëse, veç ka pasë subvencionim sepse edhe ne marrim informata që mund të jenë ndonjëherë të pasakta, por ne kemi informata se brenda këtyre 2 viteve nuk është që ka pasë ndonjë subvencionim në ndonjë fushë të caktuar të bujqësisë. Në këtë mënyrë në seancën e dt.31 kishim pasë dëshirë që ta kemi një shpjegim pak më të zgjeruar në mënyrë që ti informojmë edhe mbështetësit tonë.

Labinot Mirena –Unë kisha pasë dëshirë me ditë si është procedura e pagesës së Komiteteve, sepse sa e di unë qe 2,3 mbledhje nuk është bërë asnjë pagesë e Komiteteve.


Kryesuesja –Përgjegjet se është e vërtetë se pagesa e Komiteteve obligative nuk është bërë dhe sipas ligjit është 30 %-i i pagës bazë të anëtarëve të Kuvendit. Drejtoria e administratës bashkë me përgjegjësen e Personelit e kanë dërgue në Ministri, kështu që ju nga muaji shkurt ata që kanë qenë prezentë në Komitete retroaktiv do ti marrin mjetet, ndërsa ata që nuk kanë qenë prezentë ju heqen mjetet. Shpresojmë se me dt.31 do të rimburohen anëtarët që janë në Komitetet obligative.

Enver Gashi – Ne e patëm një takim me Ministrinë e financave dhe aty ishin prezentë edhe regjioni i Prishtinës, që sikurse ne nuk i kishin marrë mjetet, prandaj nuk është vetëm problem i Obiliqit.

Kryesuesja – Ne kishim një takim me Ministrinë e financave KPF-ja, ishte Komuna e Podujevës, Fushë Kosova, Prishtina dhe Lipjani, ishte i njejt problem, që nuk do të thotë se nuk do të paguhen, por çështja është në procedurë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:27'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

